

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim mirëmbajtje/riparim për prodhuesin ESAOTE MYLAB”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50421000-2 - Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,325,000 (një milion e treqind e njëzet e pesë mijë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Universitar i Traumës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): - Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2020-2021-2022). Vlera mesatare e xhiros së duhet të jetë jo me pak se 40% te vlerës se fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

a. Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". **Keto kritere kërkohen për të vërtetuar që OE ofertues kanë eksperiencë të ngjashme për të realizuar kontratën me sukses, shërbime të riparimit objekt prokurimi,** prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme

të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e shërbimeve të ngjashme prej 20% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të parashikuar i jep siguri AK që operatorët kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

- b. OE duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor I autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të kryejë mirëmbajtjen/riparimin ose zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të pajisjeve objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.
- c. OE duhet të paraqesë një vetëdeklarim ku të garantohet furnizimi me pjesë këmbimi origjinale/ekuivalent I tyre për pajisjet që do të mirëmbahen/riparohen. OE duhet të garantojë se pajisjet do të jenë me një garanci për të paktën një vit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të njohur origjinën e pjesëve të këmbimit dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021. OE duhet të sigurojë Ak me ane të një deklaratë ku zotohet se do të garantohet furnizimi me pjesët e këmbimit sipas kërkesave të AK.

- d. OE duhet të ketë të paktën një inxhinier biomedical/elektronik/informatik/elektrik ose fusha të ngjashme, në stafin e tij, të certifikuar/trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh mjekësore. Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesë diplomë, certifikata trajnimi dhe listpagesa të muajit të fundit ku të figurojë dhe punonjësi i deklaruar më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Sipas shtojcës nr. 5 “Formulari i specifikimeve teknike” publikuar në DT.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme janë përcaktuar përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, pika 3/b të LPP, si dhe neni 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.